



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA VAU DEJES
KËSHILLI I BASHKISË VAU DEJËS**

Nr. 4356 Prot.

Vau Dejes me 11.07.2024

NJOFTIM PËR DËGJESË PUBLIKE

Bazuar në ligjin nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” neni 18 pika 1 dhe pika 2 , neni 54 germa (e) dhe në Rregulloren e Brendshme për Funkcionimin e Këshillit Bashkiak Vau Dejës (VKB 23/2020) neni 154:

Këshilli Bashkiak Vau Dejës fton të gjithë banorët e fshatit Gomsiqe, Njesia Administrative Vau Dejës të bëjnë sugjerimet e tyre lidhur me projekt vendimin e mëposhtëm:

Projekt vendim për dhënien me qira të fondit pyjor me afat neri 9 (nëntë) vjet të sopërfaqes pyjore prej 1.95 ha “Për mbarështimin e florës së egër dhe kultivimin e bimëve të ndryshme” në ekonominë pyjore Gomsiqe.

(Paraqitur nga Drejtoria e pyjeve, turizmit dhe mbrojtjes së mjedisit-sektori menaxhimit të pyjeve dhe kullotave)

Dëgjesa publike do të bëhet me datë **08.08.2024 ora 11.30 fshati Gomsiqe**, Njësia Administrative Vau Djës.

Gjithashtu ju ftojme të bëheni pjesë e dëgjesës për projekt vendimin e mësipërm, nëpërmjet sugjerimeve tuaja në adresat elektronike:

(info@vaudejes.gov.al , ardian.celepija@vaudejes.gov.al, facebook – Këshilli Bashkiak Vau Dejës).

SEKRETARI I KËSHILLIT

Ardian ÇELEPIJA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VAU DEJES

DREJTORIA E MENAXHIMIT TË PYJEVE, INSPEKTIMIT DHE MBROJTJES SË MJEDIST
Sektori i Menaxhimit të Pyjeve dhe Kullotave

PROJEKT V E N D I M

Nr. 14, datë 26 . 02 .2024

Për

“Dhënien me qira të fondit Pyjor me afat deri 9(nëntë) vjet të sipërfaqes pyjore prej 1.95 ha “Për mbarështimin e florës së egër dhe kultivimin e bimeve të ndryshme” në ekonominë pyjore Gomsiqe .

Mbështetur në nenin 9 pika 1.2, nenin 27 pika 5, nenin 54 shkronja “e/l)”, neni 18 pika 2 të ligjit nr. 139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, në ligjin nr 57/2020 “Për pyjet”, datë 30.04.2020, ligjin nr.9693, datë datë 19.3.2007 “Për fondin Kullosor”, i Ndryshuar ;pika 49 e VKM nr. 433 datë 08.06.2016, i ndryshuar “Për transferimin në pronësi të bashkive pyjeve dhe kullotave publike, sipas listës së inventareve, dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish komunave/bashkive” pika nr 2 germa (b) dhe pika 7 të Udhëzimit nr. 1, datë 09.06.2016 të Ministrit të Mjedisit “Për Rregullat e procedurat e kërkimit të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënien në përdorim të fondit pyjor dhe kullosor publik” ,i *propozojmë Këshillit të Bashkisë Vau Dejës*, ku në mbledhjen e datës ____ . ____ 2024 të :

V E N D O S I

1.Miratimin e dhënies në përdorim të sipërfaqes prej **1.95** ha **“Për mbarështimin e florës së egër dhe kultivimin e bimeve të ndryshme”**, në ngastrën **nr.12a** të ekonominë pyjore Gomsiqe.

2.Afati i dhënies me qera të jetë deri 9 (nëntë) vjet.

3.Vlera e dhënies me qira vjetore të jetë sipas VKM nr.559, datë 29.07.2022 “Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënie në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar,për veprimtari ekonomike,si dhe për prodhimet drusore dhe jodrusore Pyjore”.

HARTOI PROJEKT-VENDIMIN

DREJTORIA E MENAXHIMIT TË PYJEVE,INSPEKTIMIT DHE MBROJTJES SË MJEDIST
Konceptoi: Mark Suli, Specialist 

Pranoi: Zeqir Ujka, Përgjegjes 

Miratoi: Vehbi Shkjau, Drejtor 

**KRYETARI
KRISTIAN SHKRELI**

**NË MUNGESË DHE ME URDHËR
ZV/KRYETARI
ALEKSANDRA GJONI**



Spektori Ligjor Kontratave dhe Çështjeve Gjyqësore, Drejtoria Juridike e Prokurimeve dhe Integritimit:

Konfirmoi bazën ligjore të projektvendimit- Ersilda Preka, Specialist 

Pranoi bazën ligjore të projektvendimit Marinela Deda, Drejtor 

RAPORT

MBI STUDIMIN TEKNIKO-EKONOMIK PËR DHËNIE NË PËRDORIM NGA FONDI PYJOR TË SIPËRFAQEVE NË PRONËSI PUBLIKE TË BASHKISË VAU DEJËS “PËR MBARËSHTIMIN E FLORËS SË EGËR DHE KULTIVIMIN E BIMËVE TË NDRYSHME”

Bazuar në **Urdhërin Urdhërin nr.36 ,datë 16.01.2024** të Kryetarit të Bashkisë për vlerësimin tekniko-ekonomik të sipërfaqes pyjore për dhënie të fondit pyjor me qira **“Për mbarëshkrimin e florës së egër dhe kultivimin e bimeve të ndryshme”**,Grupi i punës i përbërë nga **z.Zeqir Ujka Përgjegjës i sektorit të pyjeve z. Mark Suli, specialist i sek. Menaxhimit të Pyjeve e Kullotave** , nga data **05.02.2023** deri në datën **06.02.2024** realizoj studimin tekniko-ekonomik dhe verifikimin në terren,si dhe në regjistrin kadastral të sipërfaqes pyjore me objekt dhënien në përdorim(Qira) të sipërfaqes pyjore prej **1.95 ha “Për mbarëshkrimin e florës së egër dhe kultivimin e bimeve të ndryshme”**.

Mbështetur në të dhënat e regjistrit kadastral pyjor/kullosor sipas VKM nr.433,datë 08.06.2016,i ndryshuar “Për transferimin në pronësi të Bashkive të pyjeve dhe kullotave publike, sipas listës së inventarëve, dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish komunave/Bashkive,rezulton që sipërfaqja e propozuar për tu dhënë me qira është **1.95 ha** dhe bën pjesë në **ngastren nr.12a** ,ekonomia pyjore **Gomsiqe**, sipas listës së inventarit,**shtojca nr.47** dhe janë në pronësi/administrim të Bashkise Vau Dejës.

Përshkrimi parcelar i sipërfaqes objekt studimi dhe kategoria e përdorimit të saj pasqyrohen në tabelat 1 dhe 2 të këtij raporti.

Nga verifikimi në terren rezulton kjo gjendje: *(sipas tabelave përkatëse Bashkelidhur)*.

Ndërhyrjet e propozuara do të jepen në përdorim.

Procedurat që ndiqen për dhënien në përdorim nga fondi pyjor dhe kullosor publik janë të mbështetura në ligjin nr 57/2020 “Për pyjet”,datë 30.04.2020, ligji nr.9693,datë datë 19.3.2007”Për fondin Kullosor”, i Ndryshuar, Udhëzimin e Ministrit te Mjedisit nr.1 datë 9.06.2016“Për rregullat, procedurat e kërkimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullosor publik” ;

Siperfaqja e marrë në studim do ti nënshtrohet procedurës së Konkurimit publik sipas legjislacionit në fuqi.

Pas miratimit të raportit tekniko - ekonomik vazhdohet me procedure e mëtejshme të konkurimit publik.

Tarifat e dhënies në përdorim nga fondi pyjor kullosor bazohen në VKM-venë nr.559, datë 29.07.2022. “Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënie në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar,për veprimtari ekonomike,si dhe për prodhimet drusore dhe jodrusore Pyjore”,Shtojca 1, **pika 3/2**, si dhe bazohen në afatin kohor sipas grafikut të punimeve të miratuar nga institucioni përkatës dhe kategorinë e përdorimit.

Shuma në lekë/vit konsiston në:

1. Vlerën e përdorimit lekë/ha/vit “Për mbarështimin e florës së egër dhe kultivimin e bimëve të ndryshme”.

a) Ngastra nr.12a,Siperfaqe Shkurre prej 1.95 ha x 19,800 lekë = **38,610** lekë në vit

Në total 38,610(tridhjetë e tetë mijë e gjashtëqind e dhjetë) lekë në vit.

PËRPILUESIT E RAPORTIT TEKNIKO-EKONOMIK

Ing.Zeqir Ujka



Ing. Mark Suli



KONFIRMOI

**KRYETARI
KRISTIAN SHKRELI**

NË MUNGESË DHE ME URDHËR

ZV/KRYETARI

ALEKSANDRA GJONI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VAU DEJËS
DREJTORIA E MENAXHIMIT TË PYJEVE, INSPEKTIMIT DHE MBROJTJES SË MJEDIST
Sektori i Menaxhimit të Pyjeve dhe Kullotave

Nr. 17 prot.

Vau Dejës, më 26.02.2024

RELACION

Për dhënien në përdorim me kontratë qiraje të fondit pyjor për “Për mbarështimin e florës së egër dhe kultivimin e bimëve të ndryshme”

Drejtuar : Këshillit Bashkiak Vau i Dejës

Të nderuar këshilltarë,

Administrimi i fondit pyjor dhe kullosor në territorin e Bashkisë Vau u Dejës, është një ndër funksionet e Bashkisë, i përcaktuar në nenin 27 të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ku në pikën 5 të këtij neni përcaktohet: **Funksionet e Bashkive në fushën e bujqësisë, zhvillimit rural, pyjeve dhe kullotave publike, natyrës dhe biodiversitetit:**

Bashkitë janë përgjegjëse për kryerjen e këtyre funksioneve pika 5. *Administrimin e fondit pyjor dhe kullosor publik, sipas legjislacionit në fuqi.*

Ligji bazë mbi të cilin kryhet administrimi i fondit pyjor është ligji nr. 57/2020, date 30.4.2020 “Për Pyjet”, neni 25, si dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.

Bazuar në Ligjin nr 139/2015 “ Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar ,neni 9 pika 1.2 c , neni 54 pika e(1) , neni 18 pika 2 , është kompetencë e Këshillit të Bashkisë , dhënia me qira të tretëve të pronave të Bashkisë.

Udhëzimi i Ministrit të Mjedisit nr. 1 datë 09.06.2016 “ Për rregullat , procedurat e kërkimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënien në përdorim të fondit pyjor dhe kullosor publik” pika 7.

Siperfaqja e marre në studim do ti nënshtrohet procedurës së konkurimit publik sipas legjislacionit në fuqi.

Siperfaqja që kerkohet të merret në përdorim është 1.95 ha.

Në funksion të siperfaqes që merret në përdorim, sipas VKM-së nr.559, datë 29.07.2022 “Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënien në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor

kombëtar,për veprimtari ekonomike,si dhe për prodhimet drusore dhe jodrusore pyjore”,Shtojca 1, pika 3/2, si me poshtë.

3. Për mbarështimin e florës së egër dhe kultivimin e bimeve të ndryshme”				
Nr.	Përdorimi i territorit	Sipërfaqja e përdorur në Ha	Tarifa sipas kohëzgjatjes së kontratës lek/Ha/vit	
			1 vit	2- 5 vjet
2	Pyll,Shkurre	23,760	22,770	19,800

Vlera totale e pagesës/vit është: 38,610(tridhjetë e tetë mijë e gjashtëqind e dhjetë) lekë në vit.

Sipas VKM nr 748 date 01.12.2022 “Për përcaktimin e zonës ,distances dhe gjerësisë të brigjeve të burimeve ujore”,sipërfaqja qe do jepet në përdorim ndodhet jashtë bregut të liqenit sipas pikës III.5:Në liqene,rezervuarë,PELLGJE me ujë,natyrorë apo artificialë,laguna,zona dhe gjersia e bregut është hapësira tokësore e krijuar nga vija ujore tek vija e krijuar nga gjurma e lënë nga uji në vite gjatë niveleve maksimale në të gjithë perimetrin e trupit ujqor,duke krijuar aluvione apo zona të pa gjelberuara me bimësi karakteristike të përhershme të brezit të tokës.

Bazuar në sa më sipër, propozojmë miratimin e dhënies në përdorim me qera të sipërfaqes prej 1.95 ha “Për mbarështimin e florës së egër dhe kultivimin e bimeve të ndryshme”.

Bashkëlidhur po ju dergojmë.

1.Dokumentacionin e plote dhe harten e ekonomise.

Duke ju falënderuar, ju ftojme në miratimin e projekt vendimit.

Grupi i Punes

Ing.Mark Suli




Ing.Zeqir Ujka



Miratoi

Drejtori

Vehbi Shkjau






Dhënie me qira fond Pyjor

473811.170
4659822.485

473193.070
4659822.485

SHKODËR



Legjenda

Nr	X	Y
1	473531	4659620
2	473574	4659786
3	473487	4659834
4	473441	4659792
5	473433	4659730
6	473463	4659657

Kordinatat ne sistemin
KRGJSH.


473811.170
4659822.485

473193.070
4659822.485

<https://geoportal.asig.gov.al> ofron të dhëna
gjeohapësinore të ofruara nga autoritetet publike
përgjegjëse.

Përgjegjësia për saktësinë e të dhënave është e
autoritetit publik që i ka krijuar ato.

Mr. Mark Suci



Ing. Sepid Lylka

Sistemi koordinativ: KRGJSH
Projektimi: KRGJSH